



22 korrik 2014, Prizren

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e Mamushës nuk po i zbaton rekomandimet e Auditorit

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Mamushës, EC Ma Ndryshe gjatë muajit korrik ka shqyrtuar të gjeturat e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Mamushës në vitin 2013 (linku: [http://oag-rks.org/repository/docs/3\\_Report\\_Mamushë\\_13\\_ALB\\_FINISHED\\_READY\\_FOR\\_PRINT\\_876199.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/3_Report_Mamushë_13_ALB_FINISHED_READY_FOR_PRINT_876199.pdf)) me një vështrim retrospektiv edhe në raportet e viteve 2012, 2011, 2010 dhe 2009.

Konkluzioni i përgjithshëm i Auditorit është se administrimi dhe raportimi financiar brenda kësaj komune vazhdon të përballet me dobësi marrë parasysh faktin se qeveria komunale nuk i ka zbatuar rekomandimet e mëhershme të ZAP-it. "Komuna nuk i ka adresuar rekomandimet tona nga vitet e shkuara. Komuna nuk ka ndërtuar një proces të fortë që do të siguronte zbatimin e plotë dhe në kohë të rekomandimeve tona", thuhet në raportin e ZAP-it.

Ky autoritet shtetëror ka konstatuar se gjatë viteve të fundit, komuna e Mamushës ka adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet e ZAP-it lidhur me nenin 16 - Shpalosja e pasurive dhe pagesat nga palët e treta - dhe rrjedhimisht kjo fushë vazhdon të paraqesë një rrezik domethënës, pasi si pasojë e natyrës së regjistrimeve bazë dhe mungesës së dokumenteve mbështetës ekzistojnë disa pasiguri lidhur me të drejtat e pronësisë, plotësinë dhe vlerësimin e pasurive, objekteve dhe pajisjeve.

ZAP prej vitesh tërheq vërejtjen se komuna ende nuk ka një sistem automatik faturimi për të gjitha llojet e të hyrave vetanake dhe llogarive të arkëtueshme lidhur me to, ndërkohë që edhe ekzekutimi i buxhetit mbetet një nga fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime.

Auditori po ashtu ka nënvizuar se mospajtimet e identifikuar në prokurime lidhen me klasifikimet e gabuara të shpenzimeve dhe në tejkalimin e buxhetit për to. Si një shqetësim tjetër paraqitet edhe mos krijimi i një Departamenti të Auditit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditit, që po ashtu është rekomandim që përsëritet vit pas viti nga ZAP-i.

Në raportin e fundit, ZAP konstaton se komuna e Mamushës nuk e ka zbatuar asnjërin prej 9 rekomandimeve të dhëna për vitin financiar 2012, përderisa prej 11 rekomandimeve të dhëna për vitin 2011, vetëm 1 është zgjidhur dhe 3 pjesërisht janë zgjidhur. Ndërkohë prej 6 rekomandimeve të dhëna për vitin financiar 2010 komuna ka adresuar vetëm një në tërësi dhe një tjetër pjesërisht, duke injoruar 4 të tjera.

EC Ma Ndryshe vlerëson se mos adresimi i rekomandimeve të ZAP-it nga ana e komunës së Mamushës ka bërë që administrimi dhe raportimi financiar të përballet me probleme që rrezikojnë qeverisjen e mirë të buxhetit komunal.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto të dhëna, EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Mamushës që:

- Të nisë zbatimin e menjëhershëm të të gjitha rekomandimeve të ZAP-it;
- Të ndërmerr veprime serioze për përmirësimin e administrimit dhe raportimit financiar, në të gjitha fushat e identifikuara nga ZAP-i;
- Të rris transparencën në vendimmarrje me qëllim të menaxhimit më të mirë të parasë publike;

Gjithashtu, EC Ma Ndryshe rekomandon anëtarët e Kuvendit Komunal të Mamushës që të ushtrojnë presion më të madh te ekzekutivi komunal për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V) - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.